



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:141792

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05444602

PKR.nr.2023:141792

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, në përbërje të trupit gjykues prej Kryetarit të Trupit Gjykues – Gjykatësit **Drilon Haraçia** dhe gjykatësve profesional **Ilir Rashkaj dhe Driton Sadiku** - anëtar, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit A.K., nga fshati ... Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale Frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 387 parg.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.66/20223, të datës 18.08.2023, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datat 07.02.2024 dhe 29.02.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj, të dëmtuarit B. K. dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.Sahit Bajraktari nga Prishtina, sipas autorizimit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.Agron Kryeziu nga Malisheva, sipas autorizimit, me datën 05.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.13.03.2024**, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

A.K., i biri i .. , nënës .., e gjinisë .., i lindur me datë .. në fshati .. Komuna e Malishevës, ku edhe tani banon, me nr. personal ..., i martuar, at i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion zdrukthëtar dhe tani në bujqësi, i punësuar në “4xPrizma organik”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Me datë 18.09.2021 në fsh. ... K. Malishevë, rreth orës 07:00h përmes kanosjes serioze dhe premtimit të përfitimit në pagesë, ka shkuar tek i dëmtuari B.k., për të nxitur të përmbahet nga dhënia e deklaratës në polici, në atë mënyrë i pandehuri ka shkuar tek shtëpia e I.K., në fshatin ...- tek daja i të dëmtuarit dhe të njëjtit i kërkon që të shkojnë bashkë për tek B.K., që të bisedojë për një problem të mbrëmshëm që ka pasur vëllai i tij A... me të, në atë mënyrë kanë shkuar tek i njëjti ku kanë hyrë në oborr, janë takuar me të dëmtuarin dhe në bisedë e sipër në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit rreth rastit të mbrëmshëm me vëllain e tij A...që kishte përdorur armë në momentin gjersa i dëmtuari me familjen kishte qenë në rrugë të fshatit të tyre, dhe i thotë: “Tërhiqe deklaratën që ke dhënë në polici, se të paguajë për këtë gjuajtje, sa të kam borxh”, për çka i dëmtuari B..nuk pajtohet me këtë, pastaj i pandehuri i thotë: “Nëse më dënohet vëllai nga Gjykata, dikush ka me dhënë përgjegjësi” dhe me të shpejtë del nga oborri i tij ku hipë në veturë bashkë me I... e të cilin e dërgon në shtëpi aty ku e kishte marrë, me çka në këtë mënyrë me veprimin e tij të kundërligjshëm

tek i dëmtuari përmes frikësimit me kanosje serioze dhe premtim pagese i kërkon tërheqjen e deklaratës së dhënë në polici.

- **Me çka ka kryer veprën penale “Frikësimi gjatë procedurës penale” nga neni 387 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 44 69, 70, dhe nenit 387 të KPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim me pëlqimin e të akzuarit dhe mbrojtësit të tij av.Agron Kryeziu, konform nenit 44 të KPRK-së, **I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 2.500.00 € (dymije e pesëqind) euro, ku i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe **ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 500.00 € (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve.

ME DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej 3.000.00 € (tremijë) euro, ku i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuari A.K., nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në shumën prej 3.000.00 € (tremijë) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **atëherë dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve**, duke ia llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

I dëmtuari B.K., për realizimin e kërkesë – pasurore udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari A.K., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 50,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.66/2023, të datës 18.08.2023, kundër të akzuarit A.K., nga fshati ..., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale Frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 387 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari A.K., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje penale nga shqyrtimet gjyqësore është proceduar i dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit B.K., po ashtu edhe dëshmitari I.K., janë administruar provat materiale, ka bërë mbrojtjen edhe i akuzuari A.K. ,në këtë mënyrë që edhe është vërtetuar në tërësi gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzës. Gjithë kjo na ka bërë të bindemi se i akuzuari ka kryer veprën penale frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 387 par.1 të KPRK-së. Konsiderojë se mbrojtjes së të akzuarit të bërë në këtë seancë gjyqësore trupi gjykues nuk duhet të ia falë besimin për faktin se mbrojtja e të njëjtit ka të vetmin qëllim

shmang jen nga përgjegjësia penale të bëra nga veprimet e tija ditën kritike, pra me datë 18.09.2021 ndaj të dëmtuarit B.K., dhe se provat materiale dhe ato personale flasin të kundërtën e këtu të akuzuarit, andaj edhe një mbrojtje e tillë e bërë sot siç ishte bërë edhe në prokurori është pa mbështetje në prova, pasi që provat tregojnë gjendjen tjetër faktike, pra atë si në dispozitivin e aktakuzës. Lidhur me këtë trupit gjykues i propozojë që të akuzuarin ta shpalli fajtor, ta dënojë sipas ligjit, duke e obliguar në kompensimin e shpenzimeve procedura, njëherit me rastin e vendosjes mbi dënimin ia lë në vlerësim rrethanat rënduese dhe atyre lehtësuese nëse gjen.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit av.Sahit Bajraktari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështesim fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, po ashtu edhe ne konsiderojmë se në këtë procedurë penale është vërtetuar nga provat e administruara përgjegjësia penale e të akuzuarit, sidomos nga deklaratat e palës së dëmtuar dhe të dëshmitarit, të cilat në pjesën thelbësore përputhen me vet deklaratën e të akuzuarit të dhënë në prokurori, më tej i propozojmë trupit gjykues që duke pasur parasysh veprën penale e cila hynë në kuadër të veprave kundre administrimit të drejtësisë, ku e cenueshme nga kjo veprë nuk është vetëm pala e dëmtuar por vet administrimi i drejtësisë, të ketë parasysh rëndësinë e kësaj veprë si dhe rrethanat në të cilat është kryer, në lidhje me këtë vlen të theksohet se e tërë vepra është kryer pothuajse 5-6 orë pasi që pala e dëmtuar ka qenë subjekt i një veprë tjetër të vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë dhe të plotfuqishëm, rrjedhimisht të vlerësohet edhe ndikimi që ka pasur në palën e dëmtuar. Sa i përket kërkesës pasuror juridike për shkak të formës së dëmit që është shkaktuar të nijetin do ta ndjekim në procedurë civile varësisht nga vendimi i kësaj gjykate, për këtë i propozojmë që trupi gjykues të vërtetojë përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe të njëjtin ta shpalli fajtor.

I dëmtuari B. K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë deklarinimin e përfaqësuesit tim të autorizuar po ashtu edhe fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Agron Kryeziu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit të kësaj çështje penale u vërtetua se aktakuza e Prokurorisë është e bazuar vetëm në supozime dhe në deklaratën e të dëmtuarit B.K., ndërsa provat tjera materiale siç është dëgjimi i dëshmitarit dhe deklarimi i të akuzuarit i mbrojturi im nuk ka të bëjë me veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës. Dëshmitari I.K., e ka sqaruar pranë kësaj gjykate se me datën 18.09.2021, i mbrojturi im –i akuzuari A.K., ka shkuar në shtëpinë e tij dhe ka kërkuar që së bashku me te të shkojnë tek i dëmtuari me të vetmin qëllim për ti sqaruar se rasti i një nate më parë, i gjuajtjes me armë të vëllait të tij nuk ka pasur të bëjë asgjë me nipin e tij B.K.,, këtë e ka dëshmuar edhe dëshmitari I.K.,Në këtë seancë gjyqësore i mbrojturi im u deklarua lidhur me rastin e datës 18.09.2021 ku sqarojë se tek i dëmtuari kanë shkuar me qëllimin e vetëm dhe në bazë të drejtë zakonore për ti treguar se rasti i mbrëmshëm nuk ka të bëjë me te dhe gjatë bisedës asnjëherë nuk ka kërkuar që i dëmtuari ta tërheq deklaratën, nuk i ka ofruar kurrfarë favore apo kompensim, nuk ka pasur qëllimin që të ndikojë tek i dëmtuari duke i marrë për bazë deklaratën e dëshmitarit si dhe deklarinimin e të akuzuarit në këtë seancë gjyqësore nuk është plotësuar asnjë element i veprës penale frikësim gjatë procedurës penale nga neni 387 par.1 të KPRK-së. Mbi bazën e të gjitha këtyre fakteve është vërtetuar se aktakuza e PTHGj-së, është ngritur vetëm në bazë të supozimeve nga i dëmtuari, dhe nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Duke marrë për bazë të gjitha provat e administruara, gjykatës i propozojmë që aktakuzën si të tillë ta hudhë si të pavërtetuar, dhe ndaj të mbrojturit tim të bie aktgjykim lirues.

I akuzuari A.K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi deklarinimin të mbrojtësit tim të dhënë në fjalën përfundimtare dhe nuk kam tjetër se çka të shtojë.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari A.K., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova si: ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit - të dëmtuarit B.K., dëshmitarin I.K., si dhe administruar provat materiale si: raportin fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-ED-567 të datës 21.09.2021 dhe raportin e oficerit M.H., me numër të rastit 2021-ED-567 të datës 20.09.2021; si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A.K.,

2.1. Deklarata e të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit

2.1.1 I dëmtuari B.K., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike në mëngjes e kam dëgjuar dajën I.K., duke më thirrë në oborr në emër të babës D., në ato momente ka dal baba edhe daja iu ka drejtuar se kemi një problem dhe i ka thënë thirrë B.. ku kam dal edhe unë, ...i ka thënë babait tim që me i thënë B.. me e hek deklaratën, se njeri është në polici duke aluduar në A..Kam dal, dhe në ato momente kam kontaktuar me dajën dhe i kam thënë, se nuk e heki deklaratën se ka ndodhur ashtu, dhe në ato momente mu ka drejtuar baba bashkë me dajën duke më thënë veç me shkuar në polici me e hjek deklaratën, ku në ato momente ka hyrë edhe A.. pasi që ishte jashtë dyerve të oborrit, dhe daja i ka thënë babës, se është djali i T.R., vëllai i A., pasi që baba nuk i ka njohur, edhe pastaj baba dhe daja më kanë bërë presion për me e tërheq deklaratën në polici, pastaj jemi ul në terasë ku ka qenë edhe A..i cili ka ndejt në këmbë, dhe kanë nis me më bërë presion që të tretë, shko tërhiqe, dhe unë kur ka nis baba me më bërtit, unë i kam thënë, shko këqyri gratë se qysh jonë, e atëherë hajde fol, ku pastaj ka hyrë daja tek gruaja e vëllait, kur e ka pa se nuk po mundet as përgjigje me i kthyer, e kur ka dal i ka thënë A... se puna nuk koka mirë dhe nuk ka dal qysh po thu ti, dhe në ato momente ka hyrë edhe baba, i cili nuk e ka ditë ngjarjen, dhe kur e ka pa se nuk është puna mirë, kur e ka parë bashkëshorten time që nuk ka muajt as përgjigje me i kthyer, dhe ka thënë se A... nuk koka puna qysh më ke thënë ti, ka shtuar se daja ka ardh duke mos qenë në ngjarje në lidhje me rastin, dhe i ka rënë pishman daja që ka ardhur pasi që e kuptojë punën, dhe i tha A. më paske tradhtuar se puna koka keq, dhe ja kom treguar ngjarjen dajës. A.. në ato momente kur e ka pa se nuk është ngjarja mirë, dhe më tha, se vëllai mu ka dënuar 48 orë në polici, dhe nëse dënohet më shumë ti ke me dhënë përgjegjësi, na nuk të kemi ty borxh, por ti na ke neve borxh, edhe te daja R.. nuk ki shanc mo me ardh (shpija e tij tek shtëpia e A..) pa na vet neve, dhe ia kanë nis kritikën e tij dhe na ka thënë se hiq deklaratën që e ke dhënë në polici se ti paguajmë shpenzimet. E kuptova se jam duke u kërcënua prej A. caktojë njerëzit dhe ta paguajë duke i përmendur edhe disa hoxhallar dhe të paguaj për atë natë sa të këna borxh se të këna gjuajtur, por unë nuk kam pranuar i kam thënë se veç me gjykatë. Unë jam ndi shumë keq, pasi që nuk kom pas asnjëherë problem as me kojshi e as me askënd, ndërsa problemi im ka filluar te ta, jam ndi i kërcënuar, i frikësuar po ashtu kam mbetur mbas me punë, pasi që kam firmën time e kam punëtor, pasi që 2-3 muaj jam marrë me të sëmure nëpër mjek. Mua më kanë bërë presion baba, I.. dhe A.. deri sa e kanë kuptuar, deri sa e ka pa I.. kunatën se nuk është ka mundet as me fol, e më daja nuk më ka bërë presion, por iu ka lëshuar A., nuk koka puna qysh po mendoni ju, dhe as një presion më nuk kam pas prej babës e as I.. A. në ato momente ka nis menjëherë me dajën duke më bërë presion me dajën për me e tërheq deklaratën në polici dhe unë iu kam thënë se nuk është ashtu qysh po mendoni ju, po është mundu me na sqaruar rastin e një nate më përpara se nuk ka qenë ndaj teje, edhe unë e disha ngjarjen se kemi qenë aty dhe ky tha që kam qenë edhe unë aty afër dëshmitar, kur ka thënë vëllai se i kam gjuajt qenët me i vra e jo ty, ku unë i kam thënë, se ti nuk ke nevojë me na sqaruar, se nuk je kon aty, dhe se ai ka ardhur te kerri me na gjuajt. Ky si ka hyrë në oborr ka filluar me ton të lartë, me fjalë të ashpra, se hiqma vëllain prej policisë, se ke me pas telashe me neve, dhe vetëm kritika ka pas nga ai. Deri tek dyert kam dal e kom përcjellë dajën, dhe i thojke I..., hec se këta kanë me pas telashe me neve, dhe ka thënë se ky në M.. veç me pasaportë duhet me ardh, fjalën e mbramë më ka thënë, se më mirë shko hiq vëllain se ki me pas telashe me mu. Pas një muaji kanë ardhur njerëz dhe prapë kanë thënë, hiq deklaratën, dhe alltin borxh e ki 1.800,00 €, ka qenë daja im I... dhe H.. që ka ardhur dhe i kam thënë se mos hajde më se ju paraqes në polici, i ka dërguar vëllai i të akuzuarit, A.K., Ndihej i

frikësuar dhe prej asaj kohe nuk kam shkuar tek daja R... në fshatin ... Askush nuk ju ka qit kafe, as nëna nuk ka qenë e ulur ngatë jush, pasi që nëna ka qenë në ato momente ka qenë në të pame te vëllai i vet. Gjykata e ka pyet se “në deklaratën e dhënë në prokurori, keni thënë se i akuzuari të ka thënë “heke deklaratën se të kam borxh dhe ti paguaj shpenzimet”, a është e vërtetë kjo? Dëshmitari ka deklaruar se po është e vërtetë, se kur e kanë parë se unë nuk po pranojë me e tërheq deklaratën prej policisë dhe gjykatës, më kanë thënë se merri hoxhallarët Mulla Xh...dhe Mulla A... dhe të paguajmë sa të këna borxh, dhe unë nuk kam pranuar.

2.2 Deklarata e dëshmitarit

2.2.1 Dëshmitari I.K., (komshiu i të akuzuarit dhe daja i viktimës), i cili gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se po më kujtohet se kam dhënë deklaratë në polici dhe prokurori dhe mbetem në tërësi pranë deklaratimeve ndërsa lidhur me ditën kritike ka deklaruar se në orën 7 në mëngjes ka ardhur A. dhe më ka thënë se jom ardh me të marrë me shkuar tek nipi se na ka ndodhur një e keqe, A.. e ka ndal nipin tënd B.. se jonë kon me pa edhe janë ardh kur e kanë ndal nipin, dhe jonë ardh do qenë e jonë ngatërruar aty rreth kombit, e A.. i ka gjuajtur qenët, ka shtuar se më tha se kam ardh për me shkuar te nipi te B..., e me e nxjerr vëllain A.. pasi që e kanë marrë polici, kam shkuar unë me A.. në shtëpi tek B. dhe babi i tij, ku na ka pritë baba –tani i ndjeri D.. dhe kemi nis me biseduar dhe A...tha, B... jom ardh me dajën, me bacën I..., për me shkuar me tërheq A.. prej policisë se e kanë marrë policia, B... tha, jo se ja kom lënë gjykatës. Kanë bo bisedë, e këna lut, i ka bo rigja për me shkuar me e tërheq A.. duke ia shpjeguar ngjarjen se A...i ka gjuajtur qenët. A. nuk u kon gjaknxehtë, nuk ka fol keq, e këna lut, edhe baba i B. i ka thënë, se B. paska ndodh çka paska ndodh, por merre I. e shkoni në polici me e nxjerr A.. atëherë ka ardhur ajo kunata e B., në ballkonin shtëpisë aty, na ka njoftuar se këna marr infuzione, dhe jemi keq. A... i ka thënë se nëse ma dënojnë vëllain, dikush ka me dhënë përgjegjësi, nuk e kom ndi se ka thënë A.. me qu burra për këtë rast, unë kam ndejt me babën e B...e nuk e di se çka kanë thonë. Prokurorja e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori dhe atë se kur jeni pyetur në prokurori dhe të kam thënë se a i ka thënë diçka A.. tjetër B., kur B. i nuk pranojë me shkuar me e tërheq –mbyll rastin në polici, ju keni thënë se e di që i ka thënë B.. nëse ma dënojnë vëllain dikush ka me u përgjigje, si dhe keni thënë fjalët tjera nuk i mbajë në mend, prapë keni vazhduar kurse B.. i tha je ardhë në oborr dhe po më kërcënon e me dajën ke hy në oborr”. A është e vërtetë kjo çka keni deklaruar? Dëshmitari ka deklaruar se po është e vërtetë, se B.. ka thënë kështu. Kërkesa ishte për me shkuar me e mbyll rastin, dhe me e marrë A...E vërtetë është se gjendjen shëndetësore të kunatës dhe nuses dhe i kam parë se ishin marrë infuzione dhe i kam thënë, B. hajde shkojim dhe e tërheqim padijen e ta marrim A., ku pastaj B.. më tha se ja kam lënë gjykatës. A. më ka thënë se për një rast që ka ndodhur një paqartësi, me shkuar me ja sqarua rastin, se nuk ka qenë qëllimi me e gjuajt B..., por edhe me e tërheq A.. prej policisë. Aty veç unë jam kon, B.. dhe A.. dhe baba i B...tjetër kush nuk ka qenë. D..(baba i B...) nuk ka qenë në ngjarje për rastin, por kur ka ndi ka thënë shko I. dhe B. e tërhiqe rastin. B.. na ka përcjellë deri tek dyert-kombi, i cili ishte tek dyert. Gjendja e familjarëve të B., ato kanë qenë të shtrira në kauq, dhe kanë thënë se kemi marrë infuzione dhe jena tut, ku ka ardh ajo kunata prape në ballkon dhe ka fol me A., ku ka thënë se jemi tut, kemi marrë infuzione, ku A..i jepte shpjegime se A.. nuk iu ka gjuajtur juve por qenët. Po ka qenë B.i tek unë edhe pasi që ka ndodhur rasti tek unë, ndërsa tek R. nuk e di a ka qenë B.

2.3.Provat materiale

2.3.1.Nga raportit fillestar i incidentit i përpiluar nga Polica e Kosovës – Stacioni Policor në Malishevë, me numër të rastit 2021-ED-567 të datës 21.09.2021, janë konstatuar veprimet policore ku rasti është paraqitur nga i dëmtuari B.K., me dt.19.09.2021, ndërsa i dyshuar A.K., për shkak te veprës penale nga neni 387 të KPK-së.

2.3.2.Nga raporti i oficerit M.H., me numër të rastit 2021-ED-567 të datës 20.09.2021, i njëjti ka konstatuar se me dt.19.09.2021 është paraqitur ankuesi B.K., i cili ishte viktimë e rastit përdorim i armës të iniciuar me dt.17.08.2021 dhe i njëjti ka deklarua se me dt.18.09.2021 në ora 07:00, vëllai i personit të dyshuar i quajtur .A.K., se bashku me dajën e ankuesit – dëshmitari ... I.K., u kishin shkuar tek shtëpia e tij dhe kishin kërkuar që i njëjti ta tërheq rastin pasi që i njëjti vëllai u tij kishte shtënë me armë për ti fiksuar qentë endacak e jo ankuesit. Sipas ankuesit vëllai i të dyshuarit i kishte propozuar që të arrinin një marrëveshje në të kundërtën do të kesh probleme me ne dhe për këtë arsye ankuesi e ka ndier vetën të shqetësuar dhe të frikësuar.

2.4 Mbrojtja e të akuzuarit

2.4.1 I akuzuari A.K., gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet ndërsa në mbrojtën e tij ka deklaruar se me profesion jam zdrukthëtar, që 15 vite merremi me plantacione si fermer, të dëmtuarin nuk e kam njohur para datës 18.09.2021. Me armë ka gjuajtur vëllai, pasi që ai ka qenë në pjesën e lartë të plantacionit, e unë kam qenë diku 500 metra poshtë tij, unë e kam pyetur, se çka pat aty, ai më tha, se i kam gjuajtur qenët. Jam njoftuar prej policisë se vëllai im A.. është ndaluar në polici si i dyshuar se ka gjuajtur me armë personin me emrin B.K., ku më kanë thënë se vëllai do të ndalet për 48 orë për shkak se ka gjuajtur me armë për ta frikësuar B.K., Kur më ka njoftuar policia mu ka qenë pas orës 24:00/h dhe atë natë nuk kam mujt me vepruar asgjë, por të nesërmen në mëngjes kam shkuar te baca I..., pasi që e kam kojshi, (nëna e I.. është teze e babës) dhe i kam treguar për rastin se çka ka ndodhur mbrëmë, e kemi marrë bacën I., kemi shkuar tek shtëpia e B... në fshatin ... me kombi, kemi zbrit prej kombit, kemi hyrë në oborr bashkë, e ka thirre bacën D.K.,- babin e B..., pasi që ka dal D.. mu nuk më ka njohur por bacën I.. e ka njohur dhe na ka ftuar në ballkon të shtëpisë, ku jemi prezantuar dhe e ka ditur se kush jam, është qar edhe njëherë prej karriges dhe më ka fol dhe më ka përqaf, ka fillu baca I.. dhe i ka treguar për rastin e ndodhur një natë më herët, dhe menjëherë pasi ka ardhur B. aty ka ardh nëna e B., F..., është ulur afër meje, baca I.. dhe baba i B...-D...në momentin që i kemi treguar rastin i ka thënë djalit të vet B., qu shko merre dhe tërhiqe djalin e T.R., prej policisë se hor kokemi bo, pasi që baca D...me babën dhe I.. kanë pasur shoqëri shumë të mirë në mes vete, në këtë rast ka ndërhyrë edhe nëna e tij F..(bija jonë) dhe i ka treguar djalit për të bëmat nga familja jonë, dhe i kanë kërkuar B..t për me e tërheq deklaratën dhe me e marr A..., ne nuk kishim shkuar me qëllim për ta frikësuar B., po kishim shkuar vetëm për ti treguar B.. se ky rast nuk ka të bëjë me ty asgjësend, B. pasi që i ka dëgjuar prindërit e vet dhe dajën I.. dhe ka thënë, se trus se nuk dinë kurr gjë, mandej është qar nga karrika dhe ka dal në pjesën e poshtme të ballkonit, dhe çdo herë i ka thënë babës së vet, se mua më këshillojnë 2-3 policë dhe nuk e tërheki lëndën, nuk ka qenë ajo bisedë, se unë për frikësim nuk kisha shkuar tek shtëpia e B...që të mblidhen burrat sipas traditës dhe nëse ju kam borxh diçka qysh ta lënë burrat. Gjatë bisedës në ballkon, oborr edhe jashtë dyerve të oborrit, a nuk kam përdor ndonjë fjalë kërcënuese ndaj B... Nuk ishte arsyeja për të shkuar për të lutur B.. për të tërhequr deklaratën, por ishte arsyeja për të shkuar me i tregu se nuk ka qenë qëllimi me e gjuajtur atë. Po i kam thënë se nëse më rri në burg vëllai për shpifje dikush ka me dhënë përgjegjësi. Unë në plantacionin poshtë kam qenë 300 metra larg tij, kur ka gjuajtur vëllai dhe kam vrapuar dhe kam shkuar tek vëllai, aty çka ndodhi qenët ishin larguar dhe kishin shkuar tek vëllai, ndërsa bubi qeni i bardh, bubin e kam trajtuar pas 3 dite, dhe i kemi larguar qenët prej plantacionit, mbas 2-3 orë kanë ardhur policia dhe e kanë thirre A... tek dyert, pasi që ne ishim hi me pushu pak, A..ka ndejtë me polic pastaj e kanë marrë policia dhe kanë shkuar në stacion, për çka kanë qenë policia në plantacion dhe më kanë njoftuar se është ndaluar vëllai për 48 orë dhe më kanë treguar se për rastin çfarë ka qenë, dhe më kanë treguar për B.... Jo nuk kemi paraqitur, kërkesë gjykatës për shpifje B... se do të kërkojë përgjegjësi as unë e as vëllai im, pasi që nuk kemi kohë me u marrë me këto gjëra. shkove menjëherë të nesërmen për mos me ndërhy të tjerët në këtë ngjarje, për mos të shti. Nuk kam dëshmuar në proces që është mbajtur kundër vëllait tuaj, sepse nuk kam pasur kohë. Gjykata ka pyet

se sipas deklaramit të dëshmitarit I.. i njëjti gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka deklaruar se A... i ka thënë B. se nëse ma dënojnë vëllain dikush ka me dhënë përgjegjësi, pse dëshmitari I.. ka deklaruar kështu, meqenëse ju jeni kojshi dhe e keni marrë të njëjtin me ndërmjetësuar? I akuzuari Ka deklaruar se ai ka thënë aty që i ka dëgjuar, por ka mujt mos me i dëgjuar saktë, por qëllimin e ka thënë për shpifje.

3.Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën konform nenit 362 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike si vijon:

I akuzuari A.K., me të dëmtuarin nuk janë njohur para ngjarjes, një ditë para rastin – natën e datës 17.09.2021 vëllai i të akuzuarit A.K., me të dëmtuarin B.. kanë pasur një mos marrëveshje i cili kishte shtënë me armë në drejtim të veturës së të dëmtuarit dhe familjarëve të tij, ku ndaj të njëjtit ka edhe vendim të formës së prerë nga kjo Gjykate PKR.nr.148/21 të dt.10.06.2022, për veprimet e tij për shkak të veprës penale nga nenin 367 par.2 dhe veprës penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, mirëpo për shkak të hapjes së rastit dhe ndalimit në polici për 48 orë të vëllait të tij, ka rrjedh ngjarja ku i akuzuari së bashku me komshiun e tij I.. ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit B.K.,

Gjykata në bazë të prova të administruara ka vërtetuar se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale i cili nuk e mohon faktin se ka shkuar së bashku me I.. tek shtëpia e të dëmtuarit B., por mohon veprimet e tij, andaj Gjykata fillimisht ka vërtetuar faktin se me dt.19.09.2021 ka ndodhur në ngjarje në mes të vëllait të akuzuarit dhe të dëmtuarit B... dhe familjes së tij, ku vëllai i të akuzuarit është ndaluar për 48 orë në Stacionin Policor në Malishevë për shkak të rastit të ndodhur, ku i akuzuari po atë natë është njoftuar se vëllait të tij me urdhër të prokurorit të shtetit iu është caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve, ku i akuzuari A... të nesërmen pra me dt.18.09.2021 shkon tek shtëpia e dëshmitarit I.K., të cilin e kishte komshi dhe e dinte se të dëmtuarit B... e kishte nip, për të shkuar tek shtëpia e B..., ku gjykata në bazë të deklaramit të dëshmitarit I.K., ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet pasi që dëshmitari ka dëshmuar se në ora 07:00 në mëngjes ka ardhur A.. dhe më ka thënë se kam ardh me të marrë me shkuar tek nipi (i dëmtuari) se na ka ndodhur një e keqe, e me e nxjerr vëllain A.. pasi që e kanë marrë policia, kam shkuar unë me A...në shtëpi tek B.. dhe babi i tij, na ka pritë baba – tani i ndjeri D., dhe kemi nis me biseduar dhe A... tha, B. jam ardh me dajën, me bacën I.., për me shkuar me tërënjek A.. prej policisë se e kanë marr policia, B. tha, jo se ja kom lënë gjykatës, baba i B.. i ka thënë, se B.. paska ndodh çka paska ndodh, por merre I.e shkoni në polici me e nxjerr A.. atëherë ka ardhur ajo kunata e B...në ballkonin e shtëpisë aty, na ka njoftuar se këna marr infuzione, dhe jemi keq, kur B.. nuk pranojë me shkuar me e tërheq –mbyll rastin në polici, A.. i ka thënë B...se nëse ma dënojnë vëllain, dikush ka me dhënë përgjegjësi dhe ka thënë fjalët tjera por nuk i mbajë në mend, prapë keni vazhduar kurse B...i tha je ardhë në oborr dhe po më kërcënon e me dajën ke hy në oborr, andaj Gjykata ia ka falur besimin deklaratës së këtij dëshmitari pasi që i njëjti ka shpjeguar në mënyrë të qartë ngjarjes dhe është dëshmitar kredibil pasi që të akuzuarin e ka komshi dhe të dëmtuarin nip dhe i njëjti kishte shkuar me qëllim të mirë dhe nuk e kishte ditur ngjarjen në detale të dt.18.09.2021, po ashtu Gjykata ia ka falur besimin edhe deklaramit të dëmtuarit B.. të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit i cili ka dëshmuar se ka ardhur daja I. së bashku me A.. dhe daja iu ka drejtuar se kemi një problem dhe i ka thënë thirre B.. ku kam dal edhe unë, I..i ka thënë babait tim që me i thënë B... me e hjek deklaratën, se njeri është në polici duke aluduar në A...dhe pastaj baba dhe daja më kanë bërë presion për me e tërënjek deklaratën në polici, pastaj jemi ul në terasë ku ka qenë edhe A..i cili ka ndejt në këmbë, dhe kanë nis me më bërë presion që të tretë, shko tërhiqe, dhe unë kur ka nis baba me më bërtit, unë i kam thënë, shko këqyri gratë se qysh jonë, e atëherë hajde fol, ku pastaj ka hyrë daja tek gruaja e vëllait, kur e ka pa se nuk po mundet as përgjigje me i kthyer, e kur ka dal i ka thënë A.. se puna

nuk koka mirë dhe nuk ka dal qysh po thua ti, dhe në ato momente ka hyrë edhe baba, i cili nuk e ka ditë ngjarjen, dhe kur e ka pa se nuk është puna mirë, kur e ka parë bashkëshorten time që nuk ka muajt as përgjigje me i kthyer, dhe ka thënë se A. nuk koka puna qysh më ke thënë ti, daja ka ardh duke mos qenë në ngjarje në lidhje me rastin dhe i tha A.. më paske tradhtuar se puna koka keq, dhe ja kom treguar ngjarjen dajës. A... në ato momente kur e ka pa se nuk është ngjarja mirë, dhe më tha, se vëllai mu ka dënuar 48 orë në polici, dhe nëse dënohet më shumë ti ke me dhënë përgjegjësi, na nuk të kemi ty borxh, por ti na ke neve borxh, edhe te daja R... nuk ki shanc më me ardh (shpija e tij tek shtëpia e A...) pa na vet neve, dhe ia kanë nis kritikën e tij dhe na ka thënë se hiq deklaratën që e ke dhënë në polici se ti paguajmë shpenzimet. E kuptova se jam duke u kërcënuar prej A. .caktojë njerëzit dhe ta paguajë duke i përmendur edhe disa hoxhallarë dhe të paguaj për atë natë sa të këna borxh se të këna gjuajtur, por unë nuk kam pranuar i kam thënë se veç me gjykatë. Unë jam ndier shumë keq, pasi që nuk kom pas asnjëherë problem as me kojshi e as me askënd, ndërsa problemi im ka filluar te ta, jam ndier i kërcënuar, i frikësuar po ashtu kam mbetur mbas me punë, pasi që kam firmën time e kam punëtor, pasi që 2-3 muaj jam marrë me të sëmure nëpër mjek. Ky si ka hyrë në oborr ka filluar me ton të lartë, me fjalë të ashpra, se hiqma vëllain prej policisë, se ke me pas telashe me neve, dhe vetëm kritika ka pas nga ai. Deri tek dyert kam dal e kom përcjellë dajën, dhe ka thënë I..., hec se këta kanë me pas telashe me neve, dhe ka thënë se ky në fsh...veç me pasaportë duhet me ardh, fjalën e mbramë më ka thënë, se më mirë shko hiqe vëllain se ki me pas telashe me mu. Ka deklaruar se ndihem i frikësuar dhe prej asaj kohe nuk kam shkuar tek daja R.. në fshatin ... Kur e ka parë se unë nuk po pranoj me e tërheq deklaratën prej policisë dhe gjykatës, më kanë thënë se merri hoxhallarët Mulla X.H. dhe Mulla A... dhe të paguajmë sa të këna borxh, dhe unë nuk kam pranuar, ku Gjykata ia ka falur besimin dëshmitarit pasi që i njëjti ka lidhshmëri edhe me deklaratën e dëshmitarit I.K., i cili ka treguar të njëjtin version, andaj Gjykata konsideron se nga provat e lartcekura është vërtetuar se i akuzuar ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Gjykata nuk ia ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit për faktin se i njëjti ka qenë kontradiktor në deklaratimet e veta, po ashtu deklarimi i tij bien ndesh me deklarinimin e dëshmitarit dh të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, pasi që i njëjti ka deklarua se unë kam shkuar me ja shpjegua rastin e një natë më parë që kishte ndodhur ku i njëjti kishte cekur se kam qenë dëshmitar okular kur vëllai im ka shtënë, mirëpo gjykata ka vërtetuar se në procedurën e zhvilluar ndaj vëllait të akuzuarit i njëjti asnjëherë nuk është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit vërtetohet që menjëherë të nesërmen në ora 07:00 ka shkuar së bashku me dëshmitarin I. që të dëmtuarit B. jo ta tregoj rastin por ti thotë shko hiqe deklaratën në polici dhe të marrim A.. (vëllain e tij), po ashtu i njëjti ka aluduar se është e vërtet që kam deklaruar se i kam thënë B.. se nëse dënohet vëllim im për shpifje ti ki me dhëne përgjegjësi, ndërsa në rastin konkret për çfarë shpifje behet fjalë, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit dhe të dëmtuarit të njëjtit kanë deklaruar se i akuzuari pasi që i kuptoj se B... nuk po pranon me e heq deklaratën në polici, i akuzuari iu ka drejtua se nëse vëllim im dënohet ki me dhëne përgjegjësi për këtë, pra qëllimi i të akuzuarit ishte që të shkoj tek B.. që i njëjti ta tërheq deklaratën në polici, i njëjti kishte marr dëshmitarin I. si ndërmjetësues dhe në fillimin biseda kishte filluar normale duke bëra biseda normale, por kur e ka kuptuar se B.. nuk po pranon dhe i kishte thënë se jam kom lënë Gjykatës këtë punë, i njëjti fillon me kanosje duke i thënë “Tërhiqe deklaratën që ke dhënë në polici, se të paguajë për këtë gjuajtje, sa të kam borxh”, për çka i dëmtuari B... nuk pajtohet me këtë, pastaj i pandehuri i thotë: “Nëse më dënohet vëllai nga Gjykata, dikush ka me dhënë përgjegjësi” pra i njëjti me anë të kanosjes i bënë presion të dëmtuarit që të ndikoj tek ai si dhe duke i shkakuar frikë, po ashtu i ka thënë se merri hoxhallarët që të kompensoj për këtë të gjuajtur, me qëllimin se i njëjti ta heq deklaratën dhe vëllai i tij të lirohet, për çka Gjykata nuk ia falë besimin mbrojtjes së tij pasi që e njëjta është në kundërshtim me deklarinimet e dëshmitarit dhe të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit dhe provave materiale. Andaj Gjykata ka vërtetuar se faktin se në veprimet e të akuzuarit si në dispozitivit të këtij aktgjykimi ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 387 par.1 të KPRK-së.

4. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari A.K., me dashje ka kryer veprën penale Frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 387 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendim dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

5. Elementet e veprës penale

Në nenin 387 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Frikësimi gjatë procedurës penale e kryen: “Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtos dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënie e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacione e tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesë mijë (125.000) euro dhe me dënim me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet burgim.

6. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, trupi gjykues të akuzuarin A.K., e ka shpallur fajtor ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 387 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Si rrethana rënduese për të akuzuarin A.K., i ka marrë për bazë këto rrethana se i njëjti ka qenë i dënuar sipas aktgjykimit të gjykatës Themelore - Dega në Malisheve sipas lëndës me numër P.nr.55/2003, i formës së prerë me dt.26.06.2003, për shkak të veprës penale nga neni 130/1 të LPK-së, me dënim me gjobë në shumën prej 100 €, po ashtu sipas aktgjykimit të gjykatës Themelore - Dega në Malisheve sipas lëndës me numër P.nr.67/2022, i formës së prerë me dt.28.07.2023, për shkak të veprës penale nga neni 185/31 të KPK-së, me dënim me kusht 8 muaj burgim, me afat verifikimi 2 vite. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, moshën e tij, bujk, baba i katër fëmijëve dhe mbajtës i familjes. Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto gjykata ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjykata, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me kërkesën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. Agron Kryeziu, pas shpalljes së aktgjykimit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2.500.00 € (dymijë e pesëqind) Euro, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

9. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 të KPP-së.

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata ka vendosur që të akuzuarit ti detyrojë që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor duke u bazuar në nenin 449 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.6, lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafin 3 nën paragrafin 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.2023:141792, me datë 13.03.2024

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.